



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br.Prot. Prot No.	01-1538/14
Data Datum Date	30.04.2014
P-SHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 28.04.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbylllet rasti me nr. AKK-03-3552/13, për z. Shefqet Tolaj – U.d Drejtor i Institutit të Pyjeve të Kosovës në Pejë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Shefqet Tolaj – U.d Drejtor i Institutit të Pyjeve të Kosovës në Pejë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.I.P.T.SH “Valtem”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Tolaj është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtimin e funksionit publik. Fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkresë, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është bindur me fakte për situatën në të cilën ndodhet si dhe ndryshimet të cilat duhet ti bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Tolaj ka deklaruar se biznesi është pasiv, prandaj ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme në Agjensinë për Regjistrimin e Bizneseve.

Zyrtari i lartë z. Tolaj, ka dërguar në Agjenci shkresen zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03-1471/14) në të cilën vërtetohet se është bërë asgjësimi, shuarja vullnetare e biznesit privat.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

